



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 448 Prot.

Tiranë, më 02.072015

VENDIM Nr. 67 datë 23.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, të datës 23.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Hadrianopolis"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA) dhe Prof. Roberto Perna (Universiteti Maçeratës, Itali),

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim " Hadrianopolis"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA) dhe Prof. Roberto Perna (Universiteti Maçeratës, Itali), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
- Sondazhe në zonën perëndimore të Teatrit në sektorin A/W; në sektorin 7 planifikohet të përfundojë gërmimi i nisur në vitin 2014; në sektorin 5-6, gjithashtu parashikohet të përfundojnë gërmimet e nisura në vitin 2014.
 - Kërkime në zonën ekstra urbane. Ky aktivitet synon të kontribuojë në valorizimin e potencialit turistik të zonës. Veprimtaria do të përqëndrohet në zonën e Luginës së Drinosit dhe në Jergucat.
 - Restaurime të cilat do të realizohen në bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Monumenteve të Kulturës; ndërhyrje konservuese dhe konsoliduese, si për gjetjet e vogla, ashtu edhe për strukturat që janë zbuluar gjatë kërkimeve të bëra në vitet 2012-2014.
- II. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë korrik-gusht 2015.



- III. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO